

---

*Tiranë*      **14.10.2024**

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
REA MARKET 2 SHPK**

Me cilësinë e 'ortakëve themelues';

- 1) Lefter Vrapi, lindur më datë 15.10.1974, pajisur me dokument identifikimi me numër personal **H41015001E**,
- 2) Eldison Hado, lindur më datë 15.03.1996, pajisur me dokument identifikimi me numër personal **J60315001P**,  
mbështetur në legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, 'Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare', i ndryshuar, dhe në ligjin Nr. 9723 'Për Regjistrimin e Biznesit', i ndryshuar, hartojmë aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë REA MARKET 2 SHPK.

*Cel : 0674954920  
Email: [reamarket2@yahoo.com](mailto:reamarket2@yahoo.com)*

*KREU I*

*Neni 1*

*Krijimi*

Shoqëria REA MARKET 2 SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

*Neni 2  
Personaliteti juridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar ne QKB, në përpunje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria REA MARKET 2 SHPK, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortakët, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë

deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortakët gjëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesetim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

### Neni 3

#### Selia

Shoqëria e ka selinë në: Tiranë, Rruga Mihal Grameno, Njësia me Nr.pasurie 8/868-NI06, në Zonën Kadastrale me Nr. 8180.

### Neni 4

#### Objeti i veprimtarisë

Kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në:

Tregti me pakicë i artikujve industriale. Tregti me pakicë i artikujve ushqimore, pije freskuese, alkohike, prodhime bujqësore dhe blegtore. Prodhime makaronash, ëmbëlsirash. Tregti me pakicë i prodhimeve të mishit të gatshme dhe gjysëm të gatshme. Tregti me pakicë fruta-perime. Tregti artikuj veshmbathje, kancelari etj. Import-Eksport i materialeve të natyrave të ndryshme dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i tyre, si dhe import-eksport i makinerive, rafteve dhe akseorëve të nevojshëm për markete dhe supermarket. Shoqëria mund të kryejë dhe cdo veprimtaritë e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

### Neni 5

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

*KREU II*

*KAPITALI*

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në 2 kuota, i cili zotërohet si më poshtë;

- 1) Lefter Vrapi, zotërues i 1 kuote me vlerë 85 000 lekë që përbën 85 % të kapitalit të shoqërisë;
- 2) Eldison Hado, zotërues i 1 kuote me vlerë 15 000 lekë që përbën 15 % të kapitalit të shoqërisë;

Kontributi i ortakut, mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi/zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- C) trashëgimisë;
- c;) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjin Nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashegimie.

*KREU III*

*ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE*

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortakët janë organi vendimmarrës i shoqërisë që miratojnë cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të

pasqyruar ndryshimet në të dhënat e shoqerisë.

*Asambleja e ortakëve vendos për çështje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqerisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - 9) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
- 9) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, perveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10

##### Administrimi

Administrator i shoqerisë është, Eldison Hado, lindur më datë 15.03.1996, pajisur me dokument identifikimi me numër personal **J60315001P**, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori, emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve të shoqerisë.

#### Neni 11

##### Kompetencat

*Administratori ka te drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqerisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël te shoqerisë;
- 9) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto

dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Regjistrimin e Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi te veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakëve dhe në rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 per qind të aseteve te shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërime përpara të gjithë personave fizik e juridik, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhene me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me perjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12

#### Përgjegjësitet

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve te pamiratuara nga Ortakët që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", i ndryshuar, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlërësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanoste rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, te interesave personale me ato të shoqërisë;
  - d) te ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprirn ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me perjashtirn të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprirni është kryer në mirëbesim.
3. Nese administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyre të rregullt e sipas standardeve të kërkua.
4. Ne mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare", i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividente;
  - c) u shpëtndan aktivet e shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

#### Neni 13

#### Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrirnit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### Neni 14

#### Bilanci i shqëritës së dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e ortakëve vendos rrëth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të

mëparshëm finansiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 15

##### Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondevë ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë ne pronësi, ortakëve të shoqërisë.

#### Neni 17

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- 9) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar;
- d) me vendim te gjykatës;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nese ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikeqyrjes së ortakëve dhe administratorit.

## Neni 19

### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nese, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare", i ndryshuar, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërise. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqerite aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

## Neni 20

### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

## Neni 21

### Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose me shumë prej shoqërive, që quhen

shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë sere. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

#### Neni 22

##### Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërise zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar .

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palet e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" pa kryerjen e likuidimit.

#### Neni 23

##### Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi, nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

#### Neni 24

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plete me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 25

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe te tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi dhe Statut u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e lirë nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

**Lefter Vrapi**

Lefter Vrapi



**Eldison Hado**

Eldison Hado

